

Vendim nr. 294 datë 27.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Ilir Toska, Anëtar

në datën 27.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 27 (Sh) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SHPRESA QOSJA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 2761 (13-2011-6206), datë 23.12.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 10-2014-2425 (608), datë 22.07.2014 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2023-4244, datë 17.10.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Shpresa Qosja është trashëgimtare ligjore e babait të saj, shtetasit N.G., të cilit, me vendimin nr. 322/2, datë 15.04.1994 të ish-KKKP-së pranë Bashkisë Elbasan i është vendosur njohja e pronësisë dhe kthimi fizik i një sipërfaqeje prej 1500 m² të ndodhur në lagjen “Vullnetari”, Elbasan, si dhe të një sipërfaqeje prej 500 m² për efekt kompensimi. Ky vendim është bazuar në një vërtetim të lëshuar nga Zyra e Hipotekës Elbasan, i cili përmbante faktin se shtetasi K.G. ka pasur në pronësi një tokë ullishte me sipërfaqe 2000 m² në sinorin “Harmas”, Elbasan. Kërkuesja i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, me objekt vërtetimin gjyqësor të faktit se shtetasi që pasqyrohej në këtë vërtetim ishte i njëjti person me babain e saj, duke kërkuar edhe korrigjimin e emrit në vendimin nr. 322/2, datë 15.04.1994 të ish-KKKP-së pranë Bashkisë Elbasan.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 2761 (13-2011-6206), datë 23.12.2011, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Kjo gjykatë ka arsyetuar se kërkuesja ka bërë një përcaktim të gabuar të mënyrës se si i është drejtuar gjykatës, pasi sipas ligjit janë të përcaktuara rastet kur kërkohet pavërtetësia e dokumentit dhe kur kërkohet vërtetimi i një fakti juridik. Pavarësisht se objekti i kërkesës është vërtetimi i faktit se shtetasi K.G. është i njëjti person me babain e kërkueses N.G., në thelb, objekti është korrigjimi i gabimeve të bëra në një dokument zyrtar, siç është akti zyrtar i hartuar nga nëpunësi i Zyrës së Hipotekës Elbasan në datën 30.09.1940. Në këtë dokument zyrtar është bërë regjistrimi në regjistrat e pasurive të paluajtshme të kontratës së shitjes të lidhur midis një shtetasi dhe K.G., që kishte për objekt kalimin e pronësisë së një ullishteje në favor të këtij të fundit. Pra, nisur nga fakti se në rastin konkret mosmarrëveshja ka të bëjë me pavërtetësinë e një dokumenti zyrtar, ajo mund të kërkohet në rrugën e gjykimeve të zakonshme me paraqitjen e kërkesëpadisë për shfuqizimin ose ndryshimin e një akti administrativ. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesja.

3. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2014-2425 (608), datë 22.07.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2761 (13-2011-6206), datë 23.12.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me të njëjtin arsyetim, vendim ndaj të cilit ka ushtruar rekurs kërkuesja.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4244, datë 17.10.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të ushtruar nga kërkuesja, me arsyetimin se nuk parashtronte shkaqe të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, të cilat e bëjnë të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit ka respektuar ligjin

procedural dhe atë material, duke i interpretuar dhe zbatuar drejt ato, vendimi i saj nuk është në kundërshtim me ndonjë vendim njësoj të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe nuk vihen re shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurave të gjykimit.

5. Në datën 03.09.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar), kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 18.09.2024.

II

Pretendimet e kërkeses

6. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar:

6.1. *Të drejtën e pronës private të lidhur me shpërblimin e drejtë*, pasi ndonëse vendimi për kthimin dhe kompensimin e pronës në emër të trashëgimlënësit është shprehur për kthimin fizik të sipërfaqes prej 1.500 m², kërkesja nuk e ka përfituar këtë pasuri truall. Ndërsa për sa i përket kompensimit financiar për pjesën tjetër të pasurisë prej 500 m², për vlerësimin e saj është marrë për bazë vlera e pasurisë sipas zërit kadastral të kohës kur është bërë shpronësimi si “tokë bujqësore” prej 222 lekë/ m² dhe duke përdorur si çmim reference një zonë kadastrale që nuk është në kufi me pronën e njohur për kompensim. Ndërkohë Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP) është shprehur për sipërfaqen prej 1.500 m², duke e vlerësuar atë me çmimin 14.192 lekë. Ky vlerësim është diskriminues dhe alogjik, pasi e njëjta sipërfaqe toke ka vlerë të ndryshme kompensimi dhe nuk përputhet me vlerën e tregut. Kërkesja e ka kundërshtuar masën e kompensimit të pronës së trashëguar nga babai i saj në Gjykatën Administrative të Apelit dhe megjithëse ka plotësuar të metat e kërkesëpadisë brenda afatit 10-ditor, ajo gjykatë nuk i ka administruar aktet, duke vendosur kthimin e padisë pa veprim me vendimin nr. 119, datë 10.09.2018. Megjithëse kërkesja nuk ka përfituar asnjë kompensim financiar, ajo rezulton debitore ndaj ATP-së për pronën e njohur të babait të saj. Po kështu, ajo nuk mund t’i drejtohet institucioneve për kompensim, pasi emri i babait të saj nuk është i saktë në vendimin e kthimit dhe kompensimit të pronës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

7. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

8. Kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Për sa i përket legjitimitit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, përcakton afatin ligjor 4-mujor për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë nga konstatimi i cenimit. Gjykata ka pohuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Kolegji vëren se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesja, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 17.10.2023, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 03.09.2024, pra jashtë afatit ligjor 4-mujor. Për këtë qëllim i është kërkuar informacion Gjykatës së Lartë në lidhje me momentin në të cilin ky vendim është bërë i disponueshëm për palët. Sipas informacionit të përcjellë në rrugë elektronike, vendimi nr. 00-2023-4244, datë 17.10.2023 i Gjykatës së Lartë është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 15.01.2024. Gjithashtu, nuk rezulton që kërkuesja në rekurs të ketë përcaktuar të dhënat e adresës së saj elektronike, për komunikimin e vendimit, ndërsa sipas faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, kjo e fundit në datën 02.10.2023 ka publikuar çështjet civile që do të shqyrtoheshin në dhomën e këshillimit në datën 17.10.2023, ku përfshihej edhe çështja e kërkueses.

12. Ndërkohë vetë kërkuesja pretendon se është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë nëpërmjet sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate në muajin qershor 2024, pa dhënë ndonjë argument për të shpjeguar ekzistencën e shkaqeve ose rrethanave që mund ta kenë penguar për marrjen dijani me vonesë të vendimit. Ndërsa sipas shënimit të vendosur nga sekretaria e kësaj gjykate në kopjen e tërhequr nga kërkuesja rezulton se “*Vendimi u tërhoq sot dt. 13.05.2024*”.

13. Në analizë të rrethanave të mësipërme, Kolegji vlerëson se kërkuesja është pala e cila ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me anë të rekursit, në të cilin ka parashtruar shkaqet për prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta, pra ka pasur interesin dhe mundësitë për të ndjekur fatin e ankimit të saj. Në këtë kuptim, bazuar në standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, Kolegji çmon se kërkuesja konsiderohet të ketë marrë dijani për vendimin e Gjykatës së Lartë ditën e publikimit të vendimit, më 15.01.2024. Vetëm paraqitja e vendimit gjyqësor me shënimin “*Vendimi u tërhoq sot dt. 13.05.2024*” nuk provon datën e marrjes dijani efektivisht të kërkueses për të, pasi një shënim i tillë mund të vendoset nga sekretaria gjyqësore në çdo rast kur një palë ndërgjyqëse paraqitet për të tërhequr kopje të vendimit gjyqësor.

14. Nga sa më lart, bazuar në standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, Kolegji çmon se kërkuesja nuk ka arritur të provojë në nivel kushtetues se ka marrë dijani në një datë të ndryshme nga data në të cilën vendimi i Gjykatës së Lartë është bërë i disponueshëm për palët. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

15. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.